

Блаже Конески: *Историја на македонскиот јазик*, „Кочо Рацин“, Скопје, 1965 год.

Mbas një krijimtarie të plleshme shkencore nga fusha e maqedonishtes, Blaže Koneski, ordinar i filologjisë sllave dhe njani prej organizuesve të parë të Universitetit të Shkupit, botoi vjetin që shkoi historinë e parë të gjuhës maqedone.

Koneski, siç dihet, shtypi më 1952 e 1954 gramatikën e gjuhës maqedone dhe i hodhi themelet letrarishtes së maqedonishtes. Në organizimin e punës shkencore të Universitetit të ri të Shkupit, përta i përkiste fushës së maqedonishtes Prof. Koneski u shquë sidomos në editimin kritik të teksteve të vjetra të kësaj gjuhe dhe të burimeve gjuhësore të lashta — materiale me vlerë të paçmueshme të maqedonishtes. Burimet në fjalë kanë një vjetërsi të madhe, sepse datohen në perioda të hershme të maqedonishtes, që do të thotë se kjo gjuhë përfillet në kohë të mërgueta, tue zanë fill në kohën e veprimtarisë kulturele të Qiril-Metodit. Kësaj gjuhe nuk i mungojnë burime e pomendore që dalin edhe ma vonë e që qesin dritë të hapeshme ndër etapa të ndryshme në rrymën e maqedonishtes.

Me vepra të tjera nga lama gjuhësore, e sidomos me këte në shqyrtim, Koneski hodhi poshtë pa bujë fushatën joshkencore t' atyne dijetarëve që në trajtimin e problemit të origjinës së maqedonishtes buerën fillin e arsyetimit të rreptë e të shëndoshë e që në punë kësodore nuk mbajshin qëndrim të drejtë e objektiv qysh u ka hije dijetarëve të mirëfilltë. Në veprat e veta nga fusha gjuhësore, Koneski u mëshoi me prova të pakundërshtueshme por heshtas atyne qëndrimeve subjektive e të njanshme tue tregue me dëshmi të forta pamvarësinë e maqedonishtes — mise më veti në gjinin e familjes gjuhësore sllave, tue mos janë pa përmendë vendin e saj specifik ku e venduen rret-hanat e reja në viset e Ballkanit.

Shtill të posaçëm kësaj gjuhe sllave i sigurojnë pasqyrimet e gjysmëvokaleve të sllavishtes së lashtë, togjet konsonantike *tj, kt'* — *dj: sveća* — *meda: svešta* — *mezda*; mandej denazalizimi i vokaleve *e, o*, megjithëse këto reflekse as këtu nuk përfunduen në një krijim të vëtëm, me çka kjo gjuhë ze vend të posaçëm në rrethin e botës gjuhësore sllave.

Në këte mes nuk do lanë pa vu re një gja që makedonishtja në tërthoret e Ballkanit, tue ra në të përpjekun me gjuhë të nduernduerta familjesh të tjera gjuhësore, pësoi ndikime të forta apo nxitje të reja zhvillimi të atyne thalbeve që kishin qitë krye qysh në truëllin paraballkanik: kategoria enklitike tripalëshe e sistemit nominal, përmbysja e sistemit sintetik nominal dhe zavendesimi i tij me ate analitik që e ndeshim në një numër të mirë të gjuhëve ballkanike. Dalja në dritë e këtij sistemi në këto gujhë nuk do rrokë tue vështrua origjinën e tij të ardhun nga maqedonishtja a bullgarishtja, prirja e sistemit të tillë në to ngjitet në kohë shumë heret; mosha e madhe e sistemit të artikujve, sidomos sistemi postpozitiv, na shpie në periodën prehistorike të gjuhës shqipe. Lashtësinë e këtij sistemi e tregon sajimi i akuzativit të shquem njajës në gjuhën shqipe — *në (n)*, që në këte gjuhë asht përfutue prej mbaresës indoeuropiane — *m* së cilës i shtohet *t*-ja artikull: — *mt*, — *nt* = *nd* = *në*, e kjo mbështetet edhe në pluralin e prezentit: *dalënë* = *dalin* ku mbaresa — *ënë* doli nga fundorija — *onti*.

Lidhun me fleksionin nominal dhe me rrudhjen e mbaresave rasore të maqedonishtes, dmth. me tërëimin e sistemit sintetik nominal *në* ate analitik, siç u tha këtu para, na mund të përsërisim faktin e kahershëm që kjo përmbysje ndodhi në truëllin e ri, *në* ate ballkanik, e jo në treva prehistorike e paraballkanike, pse, sikur ky ndërërim të kishte ngja në vendet e hershme këte dukuni inovuese do ta kishin edhe gjuhët e tjera sllave.

Konkordancat fonetike e morfologjike me anë të të cilave lidhet maqedonishtja me bullgariishten dhe me të folme serbe, shumë dijetarë bullgarë e serbë i kanë njehë

çfaqje huazimesh prej bullgarishtes a serbishtes, e maqedonishten é pandehnin dialekt bullgar apo serb.

Njashtu në punen e reflektimit të lidhjeve të sllavishtes së vjeter: *tj, kt — dj = k, t št, žd* fjala vjen: *sveća, međa — svešta, mežda*, makedonishtja ka dy palë pasqyrimesh. Këte shtresim dy lagjesh e dëshmojnë edhe huazimet sllave në shqipen: në jugë, në toskënishten dhe gegënishten jugore lidhjet konsonantike në fjealë na dalin me —*sht, —zhd: Peshter* — kodër në veri të Elbasanit; mandej reflekset dypalshe na dalin: *megjë, megje: mezhde*.

Edhe vetë toponimia e Shqipërisë provon për mrekulli pasqyrimin e të dy palëve të lidhjeve të vjetra sllave në shqipen: *q—* e *gj—* janë vërtetue në veri të Gegënisë, ndërsa *sht —zhd* janë resleke të toskënishtes dhe të gegënishtes jugore (Selishçev, *Slavjanskoe naselenie v Albanii*, Sofje, 1931; Jokl *Studien zur albanischen Etymologie und Wortbildung; Balkangermanisches und germanisches im Albanischen*: Festschrift der Versammlung deutschen Philologen und Schölmänner in Salzburg 1929, Barić, *Istorija arbanaškog jezika*. Sarajevo, 1959; Slovenski uticaj, 44).

Po të kapim me një vështrim përmbledhës ç'u tha këtu për fatin e reflekseve të lidhjeve konsonantike të sllavishtes në shqipen, na del qartë një gjë që gjurmët sllave në toskënishten dhe në toponiminë e atjeshme, duhet të jenë nga popullsia maqedone e ato në veri do të kenë mbetë prej elementit serb a malëz.

Përsa i përket refleksit *k, t* nga lidhjet në disa të forme maqedone të sllavishtes së hershme *tj, kt' — dj*, del e qartë që ky përfitim do të jetë rezultat i ndikimit të dialekteve serbe, ndikim që përlligjet nga shtrimja e vendosja e popullsisë serbe në Maqedoni në kohën e Car Dushanit.

Po t'u sillemi përfaqësive gjuhësore të maqedonishtes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike në këte fushë veprimesh, do të gjejmë një grumbull konkordancash të shoqishojme që në këte gjuhë sllave jugore buthohen me të zanë vend të të parëve të Maqedonëve në trevat e Ballkanit, në vise të jugut, ku stërnipat e tyne gjëllijnë sot e gjithë ditën.

Siç u theksue edhe pak para, maqedonishtja me të ramë në të përpjekun me gjuhë të tjera të popujve të Ballkanit, mori e gjinikoi strukturë të re në kuptim të rrujtjes së aoristit dhe imperfektit, që një varg gjuhësh të tjera sllave i kanë bjerrë; kjo dukuni i cilëson gjuhët simotra të popujve ballkanikë.

Ballkanizëm njeht edhe përdorja e dyfishtë e objektit në maqedonishten, shqipen, bullgarishten, etj, bie fjala: *Go vidov nego* (çovekot): *e pashë ate* (njerinë); grimca përemnore nuk hyn në përdorim kur emni në akuzativ nuk asht i shquem: *Vidov eden çovek (pashë një njeri)*. Kjo çfaqje, siç provoi Koneski, na del me moshë të madhe, pse paraqitet qysh në shekullin XIII, e gjejmë në greqishten, rumanishten, shqipen.

Një veçori tjetër e maqedonishtes që shquen edhe gjuhë të tjera ballkanike asht zhdukja e infinitivit funksionin e të cilit e ka marrë koniunktivi me fjalzën *da: dojde da vidi, neke da jade = erdi të shohë, nuk do të hajë*.

Prof. Koneski ve në pah një dukuni të shpeshtë të gjuhëve ballkanike e ajo asht lëkundja e lokativit dhe e akuzativit që ka marrë përsipër funksionin e lokativit, i cili ka dalë prej përdorimit edhe në makedonishten nga ndikimi i gjuhëve të tjera ballkanike, që në përmbysjen e sistemit nominal, nga ai sintetik në ate analitik, janë rrallue rasash me të madhe; për maqedonishten mjaftojnë këta shembuj: *kaj odiš? kaj živeeš?*, përkundër dallimit të këtyne dy rasave në serbokroatishten ku akuzativi hyn në punë kur foljet përdoren me kuptime lëvizjeje, ndërsa verbet që tregojnë gjendje qetësie dalin me vështrim lokativi, bie fjala *Idem u grad: živim u gradu*.

Në vargun e përkimeve të maqedonishtes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike Koneski cek me të drejtë edhe një pikë të përbashkët të tyne e ajo asht pashirrima pyetëse *li*, që në fjalitë e pamvaruna pyetëse del si pjesëz e domos doshme në gjuhët sllave, ndërsa në maqedonishten perëndimore mungon zakonisht: *Go vide Stojana — Mu reče na Stojana?* Koneski këte paralelizëm e sheh të ardhun prej ndikimit të gjuhëve fqinje, të greqishtes, arumanishtes a shqipes, në të cilat në rrethana që u përsshkruen nuk e ndeshim zakonisht pjesëzën pyetëse: *E bane detyrën? E pe dje Agimin? U viduš casa?*

Nga lama e ndërtimeve sintaksore në mes të maqedonishtes dhe të gjuhëve të tjera ballkanike ndeshim shumë tipare takimi qysh i ve në spikamë edhe vetë Prof. Koneski: *Ke si go zememe domazet; košot go napolni slama: ke mu teče kuçata med i mleko*, e këto konstrakte përveçse me greqishten e arumanishten, lidhen për mrekulli edhe me të shqipes: *e mori grue; ata shtien pushkë; u prenë sakica, e mbushi koshin kashë*.

Në vazhdim të këtyne paralelizmave gjuhësore a ballkanizmave Koneski për maqedonishten sjell zavendësimin në përdorjen e gjenitivit partitiv nga sintagma që vijon: *Čaša voda, kilo meso*, e këte përkim e afron te gjuhët e tjera ballkanike: *E piu një kënatë ujë, — një shishe venë*,

Nga kjo fushë Koneski bie një seri pika të dituna afrimi në mes të maqedonishtes dhe të tjerave gjuhë ballkanike, që këtu nuk kemi nevojë t'i përsëdysim

Tue përfundue këto pak vrejttje mbi Historinë e gjuhës maqedone, të parën vepër kësodore të kësaj gjuhe, na nuk mund të lamë pa theksue një send, që na ka lanë mbresë të thellë e ajo asht në qëndrimin tejet objektiv që Koneski ka mbajtur në shtjellimin e veprës së përmendun. Ka pasë edhe dijetarë të tjerë që problematikën e maqedonishtes e kishin rrokë, porse trajtimet e tyre i shquente njianësia e zhdrivillimit të çashtjeve në shqyrtim dhe mungesa e plotë e objektivitetit tue rrahë ta qesin këte antare të familjes gjuhësore sllave pa ind origjinal të saj.

Kjo vepër asht drejtimdhanëse në shumë vise edhe për albanistin gjuhëtar, pse e përudh n'ato shtigje prej kah udobisht mund t'i venerojë disa cilësi të shqipes nga fusha e përmendun.

I. AJETI

